



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:078557
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05626915

PA1.nr.844/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësore Gentijana Manaj-Gashi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve: H.A , D.I, që të dy nga Gjilani dhe A.B nga fshati, Komuna e Gjilanit, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, Vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, P.nr.1129/22 të dat;s 21.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 22.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.1129/22 të dt.21.03.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin, P.nr.1129/22 të dt.21.03.2023, të akuzuarit H.A , D.I, dhe A.B , për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, Vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës i ka shpallur fajtor dhe të pandehurit H.A, i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, i cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i pandehuri në periudhën kohore prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale. Të pandehurit D.I, i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë)

muajve, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, i cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i pandehuri në periudhën kohore prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Të pandehurit A.B, i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, i cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i pandehuri në periudhën kohore prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Obligohen të akuzuarit që të paguajnë paushallin gjyqësor veç e veç në shumën prej 20 (njëzet) euro, në afat prej 15 ditësh pas ditës pasuese të plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

I dëmtuari A.N, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

Prokuroria Themelore në Gjilan PP.II.nr.962/2020 i dt. 10.05.2023, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar sa i përket vendimit mbi dënimin me burgim të kushtëzuar, ashtu që të akuzuarve H.A, D.A dhe A.B për veprën penale të lartpërmendur, për të cilën janë shpallur fajtor t'iu shqiptojë dënime më të ashpëra, konform dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.879/23 të datës 12.07.2023, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ku i njëjti aktgjykim i ankimuar të ndryshohet sa i përket vendimit lidhur me sanksionin penal, në atë mënyrë që të akuzuarve H.A, D.I dhe A.B, për shkak të veprës penale për të cilën fajësohen, t'iu shqiptohen dënime më të ashpra.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

Prokuroria Themelore në Gjilan PP.II.nr.962/2020 i dt. 10.05.2023i e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me pretendimet, se në rastin konkret Gjykata Themelore në Gjilan, të akuzuarve nuk i'u ka shqiptuar dënime të merituar në pajtim me ligjin, sepse sanksionet - dënimet e shqiptuara janë në kundërshtim me rregullat e përgjithshme mbi matjen dhe caktimin e drejtë të dënimit të përcaktuar me nenin 69, 70, 71 dhe 72 të *KPRK-së*. Rrethanat lehtësuese çfarëdo qofshin ato, nuk kanë mundur të vlerësohen në këtë masë dhe tu jepet rëndësi e tillë duke ndikuar që dënimin e parashikuar ligjor që për këtë vepër penale të zbutet gjerë në këtë nivel, ndërsa rrethanat rënduese faktin se bëhet fjalë për vepër penale me të cilën, të akuzuarit në bashkëkryerje me dashje direkte i'a kanë marrë pasurinë personit tjetër (duke vjedhur) me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, me ç'rast të akuzuarit me veprimet e tyre, të

dëmtuarit i kanë shkaktuar dëm material, e të cilat rrethana nuk kanë ndikuar në bindjen e Gjykatës që në rastin në fjalë të akuzuarve të i'u shqiptohen dënime më të rënda, të cilat të paktën do të i shërbenin të akuzuarve H.A, D.I dhe A.B, që të mos kryejnë më vepra të tilla dhe në rehabilitimin e tyre. Dënimet e shqiptuara në rastin në fjalë, Prokuroria konsideron se nuk janë në përputhje me dënimet e merituara, për faktin se jo vetëm që nuk i'u janë shqiptuar dënime adekuate në pajtim me veprimet e tyre, mënyrën e kryerjes, shkallën e përgjegjësisë penale, pasojën e shkaktuar etj, ku gjykata si rrethana lehtësuese ka marrë pranimin e fajësisë, pendimin, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra penale, që sipas vlerësimit të Prokurorisë nuk është dashur të vlerësohen deri në këtë masë sa të zbutet dënimi në këtë mënyrë. Përkundër asaj se të pandehurit kanë pranuar fajësinë, kanë shprehur keqardhje dhe kanë premtuar se nuk do të përsërisin veprime të tilla, po ashtu kur kemi parasysh, peshën e veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore, e po ti merrte parasysh këto rrethana gjykata nuk do të kishte përcaktuar një dënim të tillë dhe përkitazi me këtë Prokuroria vlerëson se gjykata nuk i ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat dhe me këtë edhe i ka minimizuar veprimet inkriminuese të akuzuarve në masë të madhe, sidomos kur kemi parasysh faktin se veprat e tilla janë në rritje e sipër dhe një dënim i tillë nuk do ti kontribuonte parandalimit, nuk shpreh satisfaksion për dëmtuarit e as gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, Duke i pasur parasysh të gjitha këto që u thanë, Prokuroria konsideron se, me dënimet e tilla nuk do të parandalohet kryerja e veprave penale dhe se me këto dënime nuk do të arrihet qëllimi i shqiptimit të sanksionit penal i përcaktuar me nenin 38 të KPRK-ës, prandaj duke vlerësuar sanksionin penal si jo adekuat për veprën penale me gjithë karakteristikat e kryerjes, rrezikshmërinë shoqërore, përgjegjësinë penale, peshën dhe pasojën e veprës penale, pas shqyrtimit të kësaj ankese si dhe të shkresave të tjera të lëndë, i propozon Gjykatës e Apelit të Kosovës ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar sa i përket vendimit mbi dënimin me burgim të kushtëzuar, ashtu që të akuzuarve H.A, D.I dhe A.B për veprën penale të lartpërmendur, për të cilën janë shpallur fajtor t'i'u shqiptojë dënime më të ashpra, konform dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP-së dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Gjilan, që të akuzuarve ti shqiptohet dënim më i ashpër, nuk janë të bazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme e cila do ta arsyetonte shqiptimin e dënimit me të ashpër për të akuzuarit. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së shqiptimit të dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, ku si rrethana posaçërisht lehtësuese për të pandehurit gjykata mori pranimin e fajësisë nga ana e tyre, pendimin e tyre, premtimin që në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tilla dhe as vepra të tjera, ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurit gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të

shfaqur nga ana e të pandehurve sepse nga përshkrimi faktik si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës del se të pandehurit këtë veprë penale e kanë kryer me dashje.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e Prokurorisë Themelore në Gjilan, nuk kanë ndikim që të akuzuarve t’iu shqiptoj dënim më të ashpër. Të gjitha këto rrethana e sidomos duke i marr parasysh pranimin e fajësisë së të akuzuarve, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t’i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.844/23, më datë 22.04.2024

Procesmbajtësja,
Gentijana Manaj-Gashi

Anëtarët e kolegjit:
Skender Çoçaj

Kryetar i kolegjit,
Ferit Osmani

Abdullah Ahmeti
